



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Në bazë të nenit 8 dhe 10 paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, si dhe Kërkesës Nr.02/8930 datë: 20.03.2024 të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për angazhimin të Asistent/e Administrativ në DBPZHR, Komuna e Kamenicës bënë këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

Për plotësimin e pozitës për kryerjen e detyrave specifike
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Titulli i pozitës: Një (1) Asistent/e Administrativ

Nr. i ekzekutuesve: (1) ekzekutues

Orar i punës : 40 në javë

Paga bruto mujore: 430 €.

Periudha e angazhimit: (120 ditë)

Detyrat Kryesore:

- Ndihmon fermerët në kompletimin e dokumentacionit për aplikime për projektet e DBPZHR. si dhe subvencioneve nga MBPZHR. për vitin 2024;
- Ju ofron ndihmë zyrtarëve të Drejtorisë së Bujqësisë kur të jenë me volum më të lartë të punëve në kërkesat e fermerëve të pemëtarisë dhe hortikulturës;
- Me stafin e drejtorisë së Bujqësisë, viziton fermerët e pemëtarisë në teren;
- Mban evidencë nga kërkesat e fermerëve në DBPZHR.;
- Asiston tek fermerët gjatë aplikimeve në projektet e DBPZHR. që do të kemi këtë vitë si projekteve për farë gruri, mekanizëm bujqësor, subvencionimin e qumështit për litër etj.
- Si dhe punët tjera që kerkohen në kuadër të Drejtorisë

Kualifikimi:

Shkolla e mesme, përvoja e punës e dëshirueshme

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartëcekur duhet t'i komplettoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (kopje) si vijon:

Dëshmi të kualifikimit shkollor

Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse ka)

Dokumentin e identifikimit.

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në Administratën Komunale në objektin e Komunës së Kamenicës.

Afati i aplikimit është 8 ditë, nga dita e shpalljes publike në Web faqen Komunale dhe tabelën e shpalljeve. "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit administrativo-teknik të administratës publike lokale". Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë mbi bazën e kriterëve të shpalljes Publike përmes njoftimit në Web faqe Komunale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA	
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE CENTAR ZA USLUGU GRADANA	
Sh. 02	Nr. 9528
U. _____	Br. _____
Nr. i faq. 1	Data: 26/03
Br. str. _____	Datum: _____
KAMENICË/A 2024	



Kadri RAHIMAJ

Kryetar i Komunës Kamenicës